



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organ Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) Rruga "MIGJENI" (ish-Banka e Ljubllanës) Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: +383 38 212 309 e-mail: oshp@rks-gov.net

PSH. nr. 793/22

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik (OSHP), në bazë të nenit 105, 106 dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës, në përbërje nga : Agon Ramadani - Kryetar, Vedat Potërqi – Anëtar, Kimete Gashi – Anëtare, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga Operatori Ekonomik (OE) "PM Group sh.p.k& N.P.T PMK Injinierring Prokim", me seli në Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me material higjenik për shkolla" me nr. të prokurimit: 632-22-5530-1-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)-Komuna e Gjakovës, me datën 22.02.2023, morri këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar, ankesa e datës 14.10.2022, e GOE "PM Group sh.p.k& N.P.T PMK Injinierring Prokim", me seli në Prishtinë, e parashtruar në Organin Shqyrtues të Prokurimit me 22.12.2022 (me numër protokolli 793/2022) për aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me material higjenik për shkolla" me nr. të prokurimit: 632-22-5530-1-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues-Komuna e Gjakovës, kurse Vendimi i cituar si më sipër i AK Anullohet, ndërsa aktiviteti i prokurimit kthehet në Rivlerësim.

II. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informoj me shkrim OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, të precizuar si në paragrafin paraprak të dispozitivit të këtij vendimi, në të kundërtën OSHP ka të drejtë të ndërmarr masa për mos respektim të vendimit, sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131, të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës.

III. Lejohet kthimi i mjeteve të deponuara me rastin e parashtrimit të ankesës, kurse Ankuesi ka të dejtë që në afat prej 60 (ditëve) të parashtrorj kërkesë për kthimin e mjeteve, në të kundërtën të njëjtat konfiskohen dhe kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale –

Me 07.12.2022, Komuna e Gjakovës, në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin mbi vendimin autoritetit kontraktues për anulim të aktivitetit të prokurimit me titull: “Furnizim me material higjenik për shkolla” me nr. të prokurimit: 632-22-5530-1-2-1.

Me datë 08.12.2022, Operatori Ekonomik “PM Group sh.p.k& N.P.T PMK Ingjiniering Prokim”, ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim pran AK- Komuna Gjakovë, me datë 12.12.2022, e ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim dhe e ka vërtetuar njoftimin mbi vendimin autoritetit kontraktues të datës 07.12.2022 .

Me datën 22.12.2022 Operatori Ekonomik “PM Group sh.p.k& N.P.T PMK Ingjiniering Prokim”, ka parashtruar ankesë në OSHP-ë, me numër të protokollit 793/2022, kundër njoftimit mbi vendimin e AK për anulim të aktivitetit të prokurimit të përshkruar si më sipër.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: Furnizim, vlera e parashikuar e kontratës: është 45 040,00€.

Ankesa e OE është ushtruar në pajtim me nenin 109.1, të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK çdo palë e interesuar mund të parashtojë ankesë pranë OSHP. Meqë OE ka ushtruar po ashtu kërkesë për rishqyrtim, do të thotë se veprimet e të njëjtit i referohen po ashtu dhe nenit 108/A të Ligjit të cituar. Prandaj OSHP konsideron se Ankesa i plotëson kushtet e parapara në kuptim të dispozitave tani më të cituara dhe e njëjta bie nën kompetencat e tij në kuptim të nenit 105, të LPP.

Raporti i ekspertit shqyrtues është pranuar nga të dyja palët, me ç'rast AK nuk është pajtuar me raportin ndërsa bazua në shkresat e lëndës OE ankues nuk ka dhënë përgjigje lidhur me të njëjtin.

- Vlerësimi dhe administrimi i provave –

Bazuar në veprimet e përshkruara si më sipër, OSHP ka angazhuar ekspertin vlerësues në pajtim me nenin 111, paragrafi 5 të LPP, me detyrë që i njëjti në kuptim të nenit 113 të Ligjit të cituar, ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore, përkitazi me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër. Lidhur me këtë, me 10.01.2023, eksperti i jashtëm shqyrtues ka dorëzuar Raportin e vlerësimit me rekomandimet si në vijim:

- ankesa OE “PM Group sh.p.k& N.P.T PMK Ingjiniering Prokim” të aprovohet pjesërisht si e bazuar.

- të anulohet Njoftimi mbi Vendimin e AK-së i datës 07.12.2022 për aktivitetin e prokurimit të lartë cekur dhe lënda të kthehet në rivlerësim.

Përgjigje në pretendimet ankimore të OE ankues "PM Group sh.p.k& N.P.T PMK Injinierring Prokim".

Përgjigje në Pretendimi nr.1

PM Group sh.p.k& N.P.T PMK Injinierring Prokim-Prishtinë pretendon se Autoritetit Kontraktues Komuna e Gjakovës nuk e ka respektuar nenin 1 të LPP-së.

Eksperti thekson se ndër tjera qëllim i këtij neni është të sigurojnë mënyrë ma efikase ,me transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike ,duke përcaktuar kushtet rregullat qe do te zbatohen, procedurat që do të ndiqen, të drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen, andaj trajtimi i OE, ankues si OE i eliminuar nuk është në harmoni me nenin 1 të LPP-së.

AK e ka eliminuar nga gara OE ankues duke pretenduar se nuk ka arritur ta ngarkojë në platformën e-prokurimit vazhdimin e sigurimit të tenderit siç ua ka kërkuar me datë 02.11.2022 duke ju jep afat deri me datën 04.11.2022.

OE ankues pretendon se ka pasur probleme me ndryshimet e bëra në platformën e-prokurimit ,mirëpo prap se prap e ka ngarkuar në platformën vazhdimin e sigurimit brenda afatit të paraparë.

Eksperti konstaton se sigurimi i tenderit (vazhdimi i sigurimit të tenderit) afati i dhënë nga AK për vazhdimin e sigurimit te tenderit ishte deri me datë 04.11.2022 dhe siç shihet në platformën e e-prokurimit OE ankues ka arritur që brenda afatit të paraparë ta ngarkojë sigurimin e tenderit në platformën e-prokurimit ku shihet në platformën se i njëjti është ngarkuar me datë 04.11.2022 në ora 13.25 h.

Eksperti konstaton se vazhdimi i sigurimi i tenderit është bërë komfor kërkesës së autoritetit kontraktues, andaj qëndron pretendimi i OE ankues. Andaj, Eksperti konstaton se ky pretendim është i bazuar.

Përgjigje në Pretendimi nr.2

PM Group sh.p.k& N.P.T PMK Injinierring Prokim- Prishtinë, pretendon se Autoritetit Kontraktues Komuna e Gjakovës nuk e ka respektuar nenin 6 të LPP-së.

Eksperti thekson se ndër të tjera qëllim i këtij neni është të siguroj që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrë me ekonomike, duke e marr në konsideratë qëllimin dhe lenden e prokurimit, andaj trajtimi OE ankues si i eliminuar nuk është në harmoni me nenin 6 të LPP-së.

Eksperti konstaton se eliminimi i OE ankues që i ka plotësuar të gjitha kriteret e parapara me NJ.K. dhe D.T. dhe që ka çmim më të lirë nuk është në harmoni me nenin 6 të LPP-së. Andaj, Eksperti konstaton se ky pretendim është i bazuar.

Përgjigje në Pretendimi nr.3

PM Group sh.p.k& N.P.T PMK Injinierring Prokim, Prishtinë, pretendon se Autoritetit Kontraktues Komuna e Gjakovës nuk e ka respektuar nenin 7 të LPP-së ,

Eksperti thekson se ndër të tjera qëllim i këtij neni është që autoritetet kontraktuese duhet ti trajtojë të gjithë operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë pa diskriminim si dhe me transparencë, gjatë udhëheqjes së procedurave të prokurimit.

Pretendimi i OE ankues lidhur me shkeljen e këtij neni: AK nuk do të ekzekutoj as një aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mesë të OE ose që diskriminon në dëm ose në të mirë të një ose me shumë operatoreve ekonomik.

Eksperti sqaron se sa i përket pretendimit të OE ankues, i njëjti pretendim qëndron sepse gjatë ekzaminimit të aktivitetit të prokurimit shihet se ka pasur shkelje në dëm të OE ankues, trajtim jo të drejtë, sepse sikurse e sqarova në pretendimin nr 1 OE ankues ka arritur ti plotësojë të gjitha kriteret e parapara me NJK dhe DT dhe është eliminuar padrejtësisht. Andaj, Eksperti konstaton se ky pretendim është i bazuar.

Përgjigje në Pretendimi nr.4

PM Group sh.p.k& N.P.T PMK Injinierring Prokim, Prishtinë, pretendon se Autoritetit Kontraktues Komuna e Gjakovës nuk e ka respektuar nenin 56 dhe 59 të LPP-së.

Eksperti fillimisht sqaron se pretendimi për shkeljen e nenit 56 dhe 59 nuk ishin pretendime edhe në kërkesë për Rishqyrtim e cila ishte dorëzuar te autoriteti kontraktues dhe bazuar në paragrafin 1 të nenit 114 të LPP dhe në paragrafin 9 të nenit 13 dhe paragrafin 1 të nenit 19 të Rregullores nr 01/2020 e punës së Organit Shqyrtues të Prokurimit, pretendimet ankimore të bëra me ankesë duhet të jenë të njëjta me pretendimet në kërkesë për Rishqyrtim andaj pasi këto dy pretendime nuk ishin edhe me kërkesë për rishqyrtim të njëjtat janë ndarë nga ana e ekspertit shqyrtues, mirëpo të njëjtat nuk kanë ndonjë ndikim në konstatimin përfundimtar të kësaj lënde.

Andaj, Eksperti sqaron se këto dy pretendim trajtohen si të pa bazuara pasi që të njëjtat nuk ishin edhe pretendime me kërkesë për Rishqyrtim.

MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, Eksperti shqyrtuese i propozon panelit shqyrtues që ankesën e Operatorit Ekonomik ta aprovojë si pjesërisht të bazuar, (për arsyet që u cekën të përgjigjet në secilin pretendim) dhe i rekomandon panelit shqyrtues që të anulojë Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues me të cilin është anuluar aktiviteti i prokurimit dhe lënda të kthehet në Ri-vlerësim.

-Seanca dëgjimore-

Paneli Shqyrtues konsideroi se lidhur me çështjen në rastin konkret, nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, konform nenit 24 paragrafi 1, i Rregullores së Punës së OSHP, përderisa pretendimet e palëve, provat, parashtrësat e tyre dhe ekspertiza e ekspertit shqyrtues, ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritior.

-Konstatimet dhe përfundimet e panelit shqyrtues

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues, deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe administrimit të provave në tërësi, e të gjithë aktivitetit të prokurimit të lartë shënuar, konsideron se gjetjet e ekspertit shqyrtues dhe mendimi i tij janë të pranueshme nga ana e këtij paneli dhe si rrjedhojë është arritur deri tek vendim-marrja e tillë që ankesa OE “PM Group sh.p.k& N.P.T PMK Injinierring Prokim”, të aprovohet pjesërisht se e bazuar, pasi që AK Komuna e Gjakovës, anulimin e këtij aktiviteti të prokurimit të sipër shënuar e ka bërë në kundërshtim me nenet 1,6,7 të LPP-së.

Bazuar në shkresat e lëndës të evidentuara nga PSH që janë të ngarkuara në e-prokurimi, me datë 06.12.2022 AK ka eliminuar OE ankues nga ky aktivitet prokurimi me arsyetimin se nuk është bërë zgjatja e sigurimit të tenderit, ndërsa me datë 09.12.2022 OE ankues ka bërë kërkesë për rishqyrtim të cilën AK e ka refuzuar me vendimin e datës 12.12.2022 me arsyetimin se nuk e keni ngarkuar me sukses dhe nuk është pranuar nga sistemi përkundër pretendimeve në probleme teknike në sistem.

Lidhur me këtë paneli shqyrtues gjatë shqyrtimit të lëndës, në platformën e-prokurimi ka evidentuar se sigurimi relevant përkundër pretendimeve të problematikave në sistem është ngarkuar me datë 04.11.2022 në ora 13:25 (si më poshtë, marrë nga e-prokurimi):

Dokumenti për dërgim te AK

Vazhdimi i Sigurimit.pdf

04.11.2022 13:25

Kodi i dokumentit: 632-22-5530-1-2-1 - 20

Hape:

 Shkarko të gjithë dokumentacionin

Shqip

11

Poashtu në përmbajtjen e dokumentit të paraqitur më lartë, evidendohet se sigurimi i tenderit është valid nga data 04.11.2022 me periudhë prej 90 ditë, konform kërkesës së AK dhe i dorëzuar poashtu brenda afatit të përcaktuar nga AK 02.11.2022-04.11.2022, andaj bazuar në të gjitha që u thanë si më sipër, PSH konstaton se eliminimi mbi këtë bazë nga ana e AK-së nuk qëndron, ndërsa udhëzohet AK që në rast se ka probleme teknike apo mungesë qasjeje në platformën e-prokurimi, e njëjta udhëzohet që ti drejtohet shërbimit të help-desk të KRPP-së si autoritet përgjegjës për ti evituar të njëjtat.

Lidhur me pretendimet të paraqitura në ankesën e OE ankues për çështjet e gjykuara në vendimin paraprak lidhur me aktivitetin e njëjtë, PSH konstaton se në vendimin mbi eliminim e OE ankues si dhe kërkesën për rishqyrtim, AK nuk paraqitur arsyetime se ka eliminuar OE ankues lidhur me

çështje të gjykuara, e poashtu as në kërkesën për rishqyrtim OE ankues nuk ka ngritur pretendime rreth çështjeve të gjykuara më parë, andaj konform raportit të ekspertizës dhe bazuar në legjislacionin në fuqi, PSH konstaton se nuk do të hidhet në trajtimin e këtyre pretendimeve për faktin se nuk kanë qenë arsye eliminimi e poashtu nuk janë të paraqitura në kërkesë për rishqyrtim, kështu që, paneli shqyrtues kërkon nga AK që të njëjtit të jenë të vëmendshëm gjatë procedurave të prokurimit publik në të ardhmen duke respektuar në përpikmëri Ligjin e Prokurimit Publik dhe rregullat e zbatueshme, dhe po ashtu urdhëron të njëjtit të veprojnë në harmoni me rekomandimet e dhëna në këtë vendim gjithashtu vendimet e kaluara lidhur me këtë aktivitet, në të kundërtën Organi Shqyrtues i Prokurimit nga kuadri i Paneleve Shqyrtuese, ka të drejtë të kërkoj ndërmarrjen e masave disiplinore ndaj zyrtarëve përgjegjës të prokurimit.

Vendimi sikurse në pikën 3, të dispozitivit është marrë në kuptim të nenit 31, paragrafi 6, i Rregullores së punës së Organit Shqyrtues të Prokurimit.

Andaj nga të lartcekurat, paneli shqyrtues në pajtim me nenin 117 të LPP-së vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryetari i Panelit Shqyrtues
Agon Ramadani

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK Komuna e Gjakovës

1x1 OE "PM Group sh.p.k& N.P.T PMK Ingjiniering Prokim", me seli në Prishtinë

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.